



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .07.2024

MBLEDHJA Nr. 27,
Datë 25.07.2024, ora 08:30
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 25.07.2024, ora 08:30**, do të zhvillohet mbledhja nr. 27 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi implementimin e intervalit kohor 15 minuta në operimin e proceseve në tregun e balancimit.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë "AGE ERZEN" për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë "SUN'S MIRACLE" shpk, për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
4. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr.254, datë 23.08.2023, "Mbi licencimin e shoqërisë "G.S.K" sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 20MW (AC).

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI